Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 16.10.2026, protokolluar me tonën Nr. 5551, datë 19.10.2023, lidhur me procedurën e prokurimit publik me objekt "Blerje bileta transporti", Departamenti i Administratës Publike (DAP) ju bën me dije si më poshtë vijon:

Në kuadër të aktivitetit "Dialogu mbi të ardhmen e qeverisjes", të zhvilluar më 9–10 shtator 2026, në Nairobi, Kenia, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin ka marrë ftesë zyrtare nga Banka Botërore.

Në vijim të kësaj, DAP i është drejtuar Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin (MAPA), me shkresën nr. 4509/1 prot., datë 19.08.2026, për miratimin e pjesëmarrjes së znj. x.y. në aktivitetin e sipërcituar. Pjesëmarrja është miratuar nga MAPA, sipas shkresës nr. 5175 prot., datë 26.08.2026.

Pas marrjes së miratimit përkatës, strukturat përgjegjëse të DAP kanë vijuar me kryerjen e procedurave administrative dhe të prokurimit për realizimin e udhëtimit, konkretisht për blerjen e biletave të transportit ajror me itinerar Tiranë - Nairobi - Tiranë.

Në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, si dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, strukturat përgjegjëse të DAP, kanë zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt "Blerje bileta transporti", me qëllim sigurimin e biletave të transportit ajror për udhëtimin e përfaqësueses së institucionit në aktivitetin e sipërcituar.

Në kuadër të kësaj procedure, dokumentacioni përkatës është publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), në përputhje me kërkesat dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të paraqitura nga katër operatorë ekonomikë, rezultoi se oferta me vlerën më të ulët ekonomike ishte ajo e paraqitur nga operatori ekonomik "ARLO Travel", në vlerën 139.200,00 (njëqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyqind) lekë, duke u shpallur fitues i procedurës, sipas rezultatit të pasqyruar në SPE dhe dokumentacionit përkatës të administruar nga institucioni.

Strukturat përgjegjëse të DAP kanë ndjekur procedurat administrative dhe të prokurimit në mbështetje të kuadrit ligjor në fuqi dhe dokumentacionit të administruar për këtë qëllim, me synim përmbushjen dhe respektimin e kërkesave ligjore.

Vlen të theksohet fakti se, vlerësimi i përputhshmërisë së procedurës me legjislacionin për prokurimin publik, në kuadër të kompetencave përkatëse, mund të kryhet edhe nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP).

Lidhur me shpenzimet për pjesëmarrjen në këtë aktivitet, bëjmë me dije se ato janë përballuar nga buxheti i DAP, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.610, datë 30.07.2026 "Për rregullat, procedurat, shpenzimet dhe kompensimin financiar për shërbimet jashtë vendit të punonjësve". Konkretisht, për një periudhë qëndrimi prej 3 ditësh, shpenzimet kanë qenë në vlerën totale prej 159.150,00 lekësh, të cilat përfshijnë, shpenzimet për dieta, akomodim, viza dhe taksi.

Sa i përket realizimit të udhëtimit, përfaqësuesja e DAP ka udhëtuar drejt Nairobit, Kenia, më datë 07.09.2026 dhe është kthyer më datë 11.09.2026.

Aktiviteti "Dialogu mbi të ardhmen e qeverisjes" është zhvilluar në datat 9 - 10 shtator 2026, në Nairobi, Kenia, ku janë trajtuar çështje që lidhen me të ardhmen e Administratës Publike, sfidat, përmirësimi i institucioneve publike, zbatimi i reformave dhe përdorimi i teknologjisë në qeverisje dhe respektivisht:

Dita e parë – Institucionet, performanca dhe zbatimi i reformave

- Institucione efektive, gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënëse: sfidat e përbashkëta për ndërtimin e institucioneve që u përgjigjen nevojave të së ardhmes.
- Performanca e administratës publike: qasje për menaxhimin më efektiv të personelit dhe lidhja ndërmjet performancës së administratës dhe prosperitetit. U përfshinë raporti përkatës i Bankës Botërore dhe përvoja nga Etiopia dhe Shqipëria.
- Udhëheqja dhe realizimi i reformave: roli i strukturave në qendër të qeverisjes, bashkëpunimi ndërinstitucional dhe orientimi i reformave drejt zgjidhjes së problemeve konkrete, me raste nga Jordania dhe Kazakistani.
- Nga projektimi te zbatimi praktik: mënyra se si reformat përshtaten kur zbatimi ndryshon nga plani fillestar. Rastet përfshinin menaxhimin digjital të personelit në Sierra Leone, pjesëmarrjen në transformimin e shtetit në Brazil, sistemet e monitorimit dhe vlerësimit në Meksikë dhe partneritetin afatgjatë Japoni–Vietnam.

Dita e dytë – Integriteti, teknologjia dhe bashkëpunimi

- Integriteti, llogaridhënia dhe angazhimi qytetar: ndërthurja e teknologjisë në qeverisje, kontrolleve të brendshme efektive dhe pjesëmarrjes së qytetarëve për të forcuar institucionet publike.
- Bashkëpunimi ndërkombëtar për zhvillim: si duhet të përshtatin mënyrën e punës qeveritë dhe partnerët e zhvillimit në kontekstin e ri ndërkombëtar.
- GovTech dhe inteligjenca artificiale: përdorimi i teknologjive të reja për përmirësimin e shërbimeve publike dhe sfidat e përbashkëta të adoptimit të tyre, duke u mbështetur edhe në përvojat e Brazilit dhe Estonisë.
- Prioritetet dhe hapat e mëtejshëm: përcaktimi i drejtimit të ardhshëm të platformës "Future of Government Dialogue" dhe i veprimeve konkrete për të vijuar shkëmbimin dhe bashkëpunimin pas konferencës.

Si përfundim, ju bëjmë me dije se kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve të DAP-it për vitin 2026, me numër rendor 32, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar.

Për çdo kërkesë tjetër për informim, mund t'i drejtoheni Departamentit të Administratës Publike në adresën elektronike info@dap.gov.al.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,